

Azra Alija

# LUNDRIM ARDHMËRIE



Tetovë, 2019

# Prozë e poezi

Azra Alija

Lundrim ardhmërie

Nëntor

2019

~ 2 ~



# Poezi

## **Mësuesja**

E dua mësuesen  
Shumë e respektoj  
Çdo gjë të mirë  
Ajo më mësoi  
Më mësoi shkronjat  
Më mësoi numrat  
Gjërat që tani  
Unë shumë i dua  
Nuk do të haroj  
Gjithmonë do të kujtoj  
Dhe në jetë mundin tënd  
Gjithmon e vlersoj.

## **Libri**

Libri im i dashur  
Pa ty s'mund të jetoj,  
Sepse prej teje  
Dituri unë fitoj.  
Sa tregime, vjersha  
Të bukura unë mësoj,  
Ato më shumë  
Dëshirë i lexoj.

## **Skolla ime**

Shkolla ime e dashur  
Sa shumë që të dua,  
Gjërat më të mira  
Mi mësove mua.

Edhe kur do dal  
Unë në pushime.  
Nuk do të haroj  
Ty oj shkolla ime.

Për ty shkolla ime  
Patronatin do ta festojmë,  
Shumë nga nxënësit  
Vjersha do të recitojnë.

Te ti mësova numra  
Shkronja dhe lexim,  
Te ti shkollë mësova  
Se si të krijojë

Për ty shkolla ime  
Çdo gjë mund të bëj,  
Se te mësojtoret e tua  
Mësova si të jetoj



Nga ti mësova jetesën  
Je pjesë e zemrës time,  
Do ngelesh në kujtesën time  
E kurë s'të haroj oj shkolla ime.

Këto vargje për ty  
Unë i kam shkruar,  
Kur do kesh ditëlindjen  
Unë kam për t'i recituar.

## **Muaj mars**

Në këtë muaj  
Është ditëlindja ime,  
Dita më e bekuar  
E jetës time.  
Në këtë ditë  
Marshojnë pa ndërprerë  
Përqafime e urime,  
Është ditë që tek unë  
Lë kujtime e gëzime.

Shumë dhurata janë mbledhur  
Asnjërën skam për ta hedhur,  
Shoqërinë e familjen  
Shumë i falemenderojë  
Sot falë jush ditëlindjen time  
Unë me gëzim e festojë.

## Shtatori

Nxënës të dashur  
Pushimi mbaroi,  
Është viti i ri shollor  
Të gjithë të mësojmë.

Ca nxënës në obor  
Disa të tjerë në koridor,  
Thërasin gjithandej  
Erdhi viti shkollor.

Shkolla po na fton  
Mësuesi po na lajmëron,  
Ejani nxënës në shkollë  
Të fillojmë të mbajmë orë.

Zilja po cicëron  
Eja nxënës mos mbeteni vonë  
Në orarin më të mirë  
Shkojmë në shkollë  
Me shumë dëshirë.

## **Prindërit**

Gjë më e shtrenjtë se ju nuk ka,  
Sa gëzohem kur thëras nënë e baba.  
Më rritët dhe më dhatë edukatë  
Më mbushët mendjen  
Me çdo të mirën fjalë.  
Falë juve u edukova  
Një poezi, juve të dy  
Unë ua kushtova.  
T'u tregoj o mbret, e mbretreshë,  
Falë juve do bëhem poeteshë.

## **Babi**

Je i vetmi që të besoj  
Sakrificat tua kur s'i haroj,  
U mundove për të më ritur mua  
Babi im, unë shumë të dua.

Ti dëshirat çdo herë mi plotësive  
Këtë poezi të shkruajtur  
Nga unë ti e meritove.

Çdo herë pranë vetes  
Më mbaje e më përqafove,  
Më edukove e më mësove.

Ti baba je një mret për mua,  
Mos haro sa fortë të dua.

## Nënës

Ti je si dielli kur agon  
Me rreze të bukura ndriçon,  
Kur të shoh më gëzon  
Jam e lumtur që egziston.

Ti Nënë je yll për mua  
Sytë e tua të shkëlqejnë,  
Duart e tua kur më ledhatojnë mua  
O sa fort unë të dua.

## **Shoqes sime**

Sa me fat që jam  
Që një shoqe si ty që kam,  
Në lidhje gjaku nuk jemi  
Por si motra ndjehemi.

Asnjëherë nuk jemi hidhëruar  
Çdo herë bashkë kemi mësuar,  
Kur të shikoj them si je motra jemi  
Je person i vlefshëm i jetës sime.

Shakatë tona janë të përditëshme  
Na bëjnë të qeshim,  
Planet tona të paaritshme.

## **Dëshira**

Në mendjen time  
Kam një dëshirë  
Të bëhem një  
Mësuëse e mirë.

Këtë dëshirë  
E kam mednduar  
Ti mësoj nxënësit,  
Duke i edukuar.

Pra kjo dëshirë  
Dua të realizohet,  
Dhe me sukses  
Të përfundohet.

Një ditë kur nxënësit  
Rrugës të më takojnë,  
Dëshiroj të më përshëndesin  
Mirdita të më thonë.



## **E vërteta**

Kështu sot u bë jeta,  
Të gjithë friken nga e vërteta.

Sot gënjeshttra e përmendur kudo,  
Të vërtetës vlera i humbi pa kohë.

Në vend se të heshtim ne gënjejmë,  
Bëjmë gabimin më të madh në jetë.

Vallë gënjeshttra ka dobi,  
Që shumë njerëz të vërtetën e kanë fobi.

Sot gënjeshttra mori shumë vlerë,  
Maskat nga fytyra nuk kanë për ti larguar.

Nuk dinë çdo të thotë fjala e vërtetë,  
Andaj mësoja kuptimin e rëndësinë.

Të vërtetës mos u bën njeri me maskë,  
E gënjeshtër gjatë gjithë jetës.

## **Fotografia**

Në fotografi  
Çdo herë të shikoj,  
Sa herë që më mer malli  
Sa herë që për ty mendoj.

Kur zemra të kërkon  
Nuk të kam pranë,  
E mar fotografinë  
Të shiqoj me mall.

Se vetëm fotografia  
Mallin ma largon,  
Se vetëm në fotografi  
Më shpesh të shiqoj.

## **Kujtimet**

Janë gjëra më të mëdha për ne  
Sepse kemi pasur njerëz që si kemi ende,  
Kujtimi është diçka e veçantë  
Sepse disa njerëz nuk i kemi më pranë,  
Më kujtohet gjithçka në këtë botë  
Nuk di si ti shprehi por vetëm me lotë.

Çdo herë do jemi shoqe  
Çdo herë do jemi së bashku,  
Çdo herë do shëtisim bashkë  
Dorë për dore si motra arbërore.

## **Vetmia**

Vetmi moj vetmi  
Kurrë nuk dua  
Të dëgjoj për ty,  
A e din ti moj vetmi  
Se nuk të do asnjëri  
Nuk të do asnjëherë  
Sepse fjala jote  
Nuk ka aspak vlerë.

## Më lëndove

Aq shumë më lëndove  
Sa që zemrën ma theve,  
Çdo të mirë që ta bëra  
Ti në lot ma ktheve.

Sa dhembje ndjeva  
Ofendimi yt më shkatërroi,  
Shpirtin tim të çiltërt  
Për një herë ma tmerroi.

Lotët që rrjedhin pa ndalë  
Mendja ime e trishtuar e paparë,  
Trupi që mu dridhte nga e pavërteta  
Thash me vete  
O Zot pse a kështu është jeta.

Vetën në pasqyrë se shikoja dot  
E pyta veten;- Mos gabova sot,  
Pse për dikë që nuk ka vlerë  
Derdha këto lotë unë si e mjerë.

## **Bota**

E dua një botë  
të lumtur e me dashuri,  
E dua një botë  
që nuk ka varfëri,  
E dua një botë  
që nuk ka lot,  
E dua një botë  
ku të gjithë janë të barabartë,  
E dua një botë  
që nuk ka njerëz krye lartë,  
E dua një botë  
ku gjëra të këqija nuk ka,  
E dua një botë  
ku gjëra të mira ka,  
E dua një botë  
ku të gjithë mësojnë,  
E dua një botë  
ku njerëzit me djersë para fitojnë,  
E dua një botë  
të lirë me liri,  
E dua një botë  
ku nuk ka ofendim.

## **Loti i mërgimtarit**

Loti si pushon  
Nënë po mendon,  
Gjith në vaj u bëra mërgimtar  
Vallë përsëri kam për t'iu parë.

Loti i mërgimtarit  
Me asgjë nuk ndalet,  
Le të flet gjithkush  
Le të digjen edhe malet.

Se vetëm mërgimtari  
Ndjen mall për atdheun,  
Ndjen mall për familjen  
Ndjen mall për folenë.

Se unë si mërgimtar  
Largimin e përjetova,  
Çdo të thotë mërgimtar  
Atë ditë e kuptova.

Që atë ditë kurë më nuk u ktheva  
Ashtu e deshi puna,  
Ashtu e deshi jeta  
Në vend të huaj mbeta.

Tani më, mëmëdhenë  
Vetëm në ëndërr e shoh,  
Duket sikur jam atje,  
Sikur jam, në mëmëdhe.



## Vendlindja ime

Sa të dua moj vendlindje  
Te ti kam shumë kujtime,  
Sa kam lozur sa kam vrapuar  
Me shumë njerëz jam njoftuar.

Ti për mua je gjithçka  
Një pasuri që fund nuk ka,  
Jo, jo ska si në vendlindjen tonë  
E s'mund të gjendet si lagjia jonë.

Në çdo rrugicë kam kujtime  
Do jenë pjesë e fëmijërisë sime,  
Zogjtë kur fluturojnë  
Mua shpirtin ma lumturojnë.

Kur dielli në mëngjez ngroh  
Natyra shumë shpejt lulëzoon,  
Për mua je dukuri si në përalla  
Me lotë fush e ara.

Te ti, balta, është me ëmbël  
E më e mirë se mjalta,  
Për çdo ditë me hare punojmë  
Për të lëvruar arën tonë.

S'ka si vendi ku jetojmë  
Ndjej rehati e plot emocion,  
Gëzim të madh në zemër përjeton  
Lumturi, në vendlindjen tonë.

Më nuk ka kthim mbrapa  
Atje nuk mund të jem,  
Dhe kujtimet që më kanë mbetë  
Mërgimtar, do ngelem për jetë.

## **Lulja**

Lulet janë mrekulli e vërtetë,  
Janë gjëja më bukur në jetë.

Unë ata i dua shumë,  
Iujis e i kultivoj pa fund.

Lulet çelin në stinën më të bukur,  
Dhe kanë ngjyrë si një flutur.

## **Dimri**

Acari i ftohtë në dimër  
Njerëzit vishen trashë,  
Fëmijët kanë ftohtë  
Nuk mund të dalin jashtë.

Që të mos sëmuren  
Hanë sup e pijnë çaj,  
Natën mos kenë ftohtë  
Flejnë me jorgan.

Akujt janë varur  
Te cepat e shtëpive,  
Çezmat janë ngrirë  
Gjithçka sikur është  
Mbyll në dry.

Prej të gjitha stinëve  
Dimri është ftohtë,  
E të tjera stinët  
Motin na ngrohin.

## **Bora**

Bie bora e bardhë  
Fëmijët i gëzon,  
Çdo lule të bukur  
Ajo e mbulon.

Fëmijët lozin me topa bore  
Rëshqasin me sajë e ski,  
Në oboret e shtëpive  
Lozin plot fëmijë.

Bëjnë dordoleca  
Te hunda i vënë karotë,  
Ia vënë shallin lara- lara  
Natën të mos ketë ftohtë.

## Viti i Ri

Fëmijët po vrapojnë  
Fishekzjare po kërkojnë,  
Po kërkojnë anë e mbanë  
Që t'i pëlcastin për një vit të mbarë.

Fëmijët sa e duan Vitin e Ri  
E stolisin bredhin me stoli,  
E ambientin për rreth me dashuri  
Që të gjithë të festojnë Vitin e Ri

Të gjithë fëmijët gëzohen  
Rreth bredhit rrethohen,  
Janë aq shumë të gëzuar  
Njëri tjetrin duke e uruar.

Na pëlqen Viti i Ri  
E fillojmë një vit të mbarë,  
Fëmijët e vegjël me dashuri  
Fishekzjaret duke i parë.

Në gjithë botën festohet  
Për Vitin e Ri urohet,  
Më të gëzuar së fëmijët nuk ka  
Na duken sikur kanë krahë  
E fluturojnë me ta.

# Prozë

## Një ngjarje e paharuar në bankat shkollore

A thua vallë si mund ta haroj ditën e parë që shkuam në shkollë, ishte dita më e lumtur e jetës sime. Vendosëm libra, fletore, lapsa në çantë, çantën e vura në krah dhe morëm rrugën për në shkollë së bashku me anëtarët e familjes. Edhe pse shkollën e kam aq afër, atë ditë kjo rrugë mu duk aq e gjatë sa që mezi prisja të jem e rreshtuar në koridorin e shkollës.

Shkolla mu duk aq e buskur si të ishte Pallat mbretor i përallave nëpër libra. Qëndronin shumë fëmijë me familjarë e prisnim që të na vendosnin nëpër klasa. Dikur nga shkallët zbritën Mësueset me Pedagogen, e cila kishte ca letra në dorë, e pasi u përshendetën filluan të na thërrasin me emra. Sejcili që dëgjonte emrin shkante te klasa e njëjës nga mësueset. Klasa ishte dhoma im e dytë. Bankat, kariket, tabela ishin më të ëmbëla se një ëmbëlsirë. Nga ajo ditë unë zgjërrova shoqërinë, ishte ngjenje shumë e bukur të shoqërohesh me shoqe e shokë që për së pari her i sheh.

Tingëllimi a ziles, që na ftoi në pushimi e parë, ishte aq tërheqës dhe i njëjtë si kënga e bilbilit që këndon në kaçubat rreth shtëpisë time, në Pranverë. Më e bukur se Mësuesja ime, atë ditë nuk kishte. E gjeta nënë time të dytë. Mësuesja ishte aq e mirë, të gjithve na këshillonte, ledhatonte, na mësonte, në çdo vështërsi detyre na ndihmonte, pra mundohej me çdo kusht të jemi nxënës të mirë dhe si të tillë të qëndrojmë edhe me tej. Kështu na thoshte ajo gjithmonë.



Prej ditës së parë e mësuesen e konsideroj Nënë time të dytë.

Eh detyrat....., detyrat ishin obligimi im i preferuar, i kryeja ato në klasë dhe vazhdimisht shikoja klasën, shokët e mësuesen. I ndihmoja të realizojnë detyrat edhe shoqeve dhe shokëve të cilët ngelnin pas. Pas ditës së parë, filloi dashuria ime për shkollën, nuk dëshiroja të ndahesha as edhe një minutë prej sajë.

Para dite qëndroja te pragu i derës së shtëpisë, e sodisja shkollën time, ëndëroja sy hapyr gjithçka për shkollën dhe rreth sajë.

Ndjesia më e mirë ishte kur më thërisnin nxënëse, ndjehesha aq e lumtur sa asnjëherë më parë. Nga ajo ditë, deri në pafundësi , momente më të bukura të kaluara në bankat shkollore nuk do t'i harojë. Këtë ditë të rëndësishme të jetës sime shumë e vlersoj, nga ajo ditë shkolla është shtëpia ime e dytë.

Mësuesët, janë vlera e paçmuar e jetës sime.

Klasa dhoma e dytë te e cila kaloj gjysmën e jetës dhe thesari i jetës është shoqëria ime, me të cilët kaloj shumë kohë, e me të cilët shpалosim edhe shumë sekrete të jetës sonë.

## **Libri i mësuesit tim**

Fjala kursim, dikur ishte një fjalë e panjohur në fjalorin tim, një gjë jo e praktikueshme në rrutinën time ditore. Sot unë shumë mirë di të kursej. Unë di se çdo të thotë të kursej dhe çfarë janë të mirat e kursimit. Isha klasa e pestë, ishte dimër, bënte ftohtë. Unë shkoja në shkollë me shumë dëshirë edhe pse bënte ftohtë dhe më duhej për të ecur deri te shkolla gati se çerek ore më tepër se rëndomë. Ishte Lënda e Gjuhës, e cila më tërhiqte më shumë, dhe shkak që unë gjithmonë shkoja e lumtur në shkollë. Ndodhi një ditë, erdhi arsimtari në klasë jo si ditët tjera me ditar në dorë, por së bashku me të kishte edhe një libër. Ai vazhdoi, shënoi orën mësimore, pyeti se kush s'ishte prezent në klasë dhe më pas filloi të spjegoj njësinë mësimore. Unë gjithë kohës mbaja sytë te libri. Ishte një libër voluminoz me një kopertinë të bukur, të kuqe në të zezë, por ajo që më tërhiqte më së shumti ishte titulli i tij "Si të kursej". Mësuesi përfundoi orën mësimore dhe doli. Unë e ndoqa nga prapa, e ndalova dhe i thash:- Se isha shumë e interesuar për atë libër e veçanërisht për përmbajtjen e tij.

-Ai më u përgjigj:- Unë po të tregoj se ku e bleva, kurse përmbajtjen do ta kuptosh pasi ta lexojsh, e më pas edhe shoqeve t'ua spjegosjsh. Pranova kushtet e vendosura nga arsimtari. Pas orëve mësimore shkova të kërkoj librin, e gjeta në raftet e librarisë. Ishte shumë i

shtrenjtë. Fillova të mendoj se si të arij që ta bleje. Mu kujtua që duhej të kursej. Që të nesërmen fillova të kursej. Nga 40 denar që më jepnin prindët për harxhime ditore në shkollë, unë kursejja plot 20 denar. Mu deshtën plot njëzet ditë që të kursej shumë e duhur për të blerë librin e ëndrave të mia. Arita ti kursej, isha shumë e lumtur, i mora paratë dhe u nisa për te libraria për ta blerë librin tim.

U dëshpërova sepse libri nuk gjendej më në librari, e kishin shitur. Ashtu e mërzhitur dola nga libraria, mora rrugën që të kthehesha në shtëpi. Për ballë meje, në skaj të rrugës pash një skamnor i cili kishte shtri dorën dhe lypte para për bukën e gojës . Për një herë vendosa t'ia jepja paratë e kursyera këtij skamori, që të paktën të ngop barkun e fëmijëve me bukë. Vërtetë librin nuk arita ta blej, por bëra një gjest të mirë e human. Pas disa ditësh mësuesi më kërkoi që ti spjegoj nga ajo që kisha lexuar nga libri. Ai nuk e dinte se unë akoma nuk e kisha blerë librin. Unë duke mos u ndjerë në faj dhe e turpëruar i tregova për ngjarjen shtu siç kishte ndodhur.

Mësuesi tha:- E shikoni nxënësit e mi, se si shoqja e juaj vetëm duke pa titullin e librit “Si të kursejsh”, gjeti mënyren për të mbledhur të holla që të blente librin. Eh...sikur ta kishte blerë, sa do të mësonte nga faqet e tijë. Shoqja juaj, jo vetëm që mësoj të kursej, por mësoi edhe rëndësinë e kursimit. Mësuesi na e dha librin e tijë, ne të gjithë në klasë e lexuam këtë libër. Nga ai mësuam se si të kursejm. Që nga ajo ditë, të gjithë në klasë kursejmë para për të ndihmuar familjet në

nevojë, me aq sa kemi mundësi.

Shpesh hërë i them vetes:- Më mirë që se bleva, sepse bëra një gjest të mirë sepse po ta kisha blerë librin , nuk do të mundja të ndihmoja një nevojtar .

## **...Dhe unë dua të ndryshoj Botën...**

Bota për mua është një botëkuptim shumë i gjërë, në vete ngërthen shumë hapsirë, megjithatë edhe unë nuk pajtohem me shumë gjëra që ndodhin rreh sajë e në të. Do të doja të ketë ndryshime në botë dhe njerëzit që jetojnë të. A thua vallë sa vajza e sa djem do të konkuronin për të ndryshuar botën. Do të mblidheshim dhe do të mundoheshim disi ta ndryshojmë botën, por a thau vallë si do të ndryshonim botëkuptimet e njerëzve për përditëshmërinë rreth botës. Natyrën do e pastronim, do e ndryshonim duke i dhënë forma më të mira të mundëshme por si do të ndryshonim njerëzit, të cilët të jo rrallë herë me vetëdije e shkatrojnë hapsirat që i rrethojnë. Do të ndryshonim botën duke e pasuruar me libra, por si si do të ndryshojmë njerëzit që librin e lënë anash e fare nuk iu shkon mendja që ta shfletojnë. Do të ndryshonim botën në qoftë se telefonat më pak do ekzistonin, por si do ta ndryshojmë njerëzit që pa telefon (celular) nuk të qëndrojnë as edhe një minutë dhe duke shkaravitur gjëra të pavlera ndikojnë që kjo botë njerëzore të vetë shkatrohet. A nuk duhet që me çdo kusht të isistohet, te disa “Baballarë të botës” të cilët për interes material, kënaqësi shpirtrore e për të treguar “Muskujt se kush është më i forti i botës”, shkatrojnë qytete të tëra, i detyrojnë njerëzit dhe ushtarët të luftojnë pa dëshirën e tyre, vrasin të pafajshëm, vrasin edhe fëmijë të cilët ende nuk dinë çështë bota, në prag të shtëpive të tyre.

A nuk duhet që këto dukuri më të shumtuara të ndryshohen. A nuk duhe të që këtyre “ të mëdhenjëve” t’iu thuhet mjaft më. Jam edhe unë dëshmitare e skamjes që ka kapluar familje edhe këtu në vendim tim. Sapo të dalësh në qytet, gjithandej sheh njerëz që shtrinë duart e lypin lëmosh, dhe më keq shohë edhe bashkëmoshanik të mi, që po ashtu shtrinë duart e lëmoshës. Në vënd që të jenë nëpër banka shkollore, këta bashkëmoshanik enden rrugëve për një racion buke, që në mbrëmje do ta kenë apo jo, për veten dhe familjen. A nuk duhet ndryshohet, a nuk kanë edhe këta fëmijë të drejtë të mësojnë si të tjerët gjithandej nëpër botë, të mësojnë e t’i shfrytëzojnë të drejtat elementare të tyre. Dhe më keq për çdo ditë po shprazen bankat e shkollës time si shkak i mërgimit ekonomik të familjeve. Në shumë shtëpitë e lagjes sime më duket njeri në oboret e shtëpivë të tyre, nuk del tym nga oxhaku i tyre dhe fatkeqësish në disa prej tyre kanë ngelë vetëm pleq të ngratë të cilët kanë nevojë për gjithçka.

Bota do të ndryshonte në qoftë se natyra do të ishte e pastër, do të lexonim më shumë libra, nuk do të kishte tragjedi shumë të mëdha në shkatrimine pasurive, vrasje, dhe më keq shkatrimin e lumturisë së fëmijëve. Të gjithë këto dukuri negative, ne së bashku do t’ia dilnim ti evitojmë nga përditëshmëria jonë. E keqja e madhe qëndron te njeriu i cili edhe përkundër kësaj, megjithate nuk dëshiron të ndryshojë veten. Nuk dua të keq kuotohem ka edhe shumë njerëz të mirë në këtë botë, por ajo pakicë po na e prish qetësinë shpirtrore.

Po mundohem ti kuptojë këta njerëz që janë pakicë, se dëshirojnë ashtu si dëshirojnë të jetojnë jetën e tyre, po nuk i kuptoj pse këmëngulin që edhe ne pasardhësit e tyre duhet me çdo kusht të jemi në të njejtën linjë të jetës. A nuk kemi të drejtë që ne ta rindërtojmë jetën sipas mundësive dhe dëshirave tona, ta bejmë të lumtur për lumturinë tonë. Sa do që të mundohemi të ndryshojmë diçka në këtë botë, pa ndryshuar bindjet e njerëzve për botën siç duket gjithçka është e kotë. Andaj, ju ftoj juve o bashkëmoshanik e ju njerëz të tjerë, ejani ta ndryshojmë veten, sepse siç duket ne jemi të pandryshueshmit pavarësisht se bota ndyshon. Edhe unë dëshiroj të jap kontributin tim, që të ndryshojmë botën, për një të ardhme më të mirë.

## Përmbajtja

Mësuesja .....	6
Libri .....	7
Skolla ime .....	8
Muaj mars .....	10
Shtatori.....	11
Prindërit .....	12
Babi.....	13
Nënës .....	14
Shoqes sime .....	15
Dëshira .....	16
E vërteta .....	17
Fotografia.....	18
Vetmia .....	20
Më lëndove .....	21
Bota.....	22
Loti i mërgimtarit.....	23
Vendlindja ime .....	25



Lulja.....	27
Dimri.....	28
Bora .....	29
Viti i Ri.....	30
Një ngjarje e paharuar në bankat shkollore .....	32
Libri i mësuesit tim.....	34
...Dhe unë dua të ndryshoj Botën.....	37

Autore : Azra Alija


Titulli: Lundrim ardhmërie

Redaktor : Muaxher Haruni

Radhitja kompjuterike : Emine Haruni

Shtypshkronja : Luma Graphic

Tirazhi : 250



Azra Alija lindi në Tetovë në vitin 2007,  
bashkëjeton me familjen në fshatin Trebosh.  
Është nxënëse në klasën e shtatë në shkollën fillore  
komunale “Fan Noli” të Treboshit.  
Me krijime letrare është marrë që nga klasa e pestë.  
Ka marrë pjesë në gara të ndryshme poetike të  
organizuara nga institucionet e ndryshme komunale  
e regjionale. Përveç poezisë, Azra ka konkuruar  
edhe në gara tjera, me shkrime në prozë. Kjo është  
vepra e parë e saj.